



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010) dhe nenit 5.3 të Ligjit nr. 04/L-101 dhe Ligjit nr.04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2016 miratoi

RREGULLORE PËR RAPORTIM TË FONDIT TË KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë afatet dhe rregullat e raportimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në BQK dhe në Kuvendin e Kosovës.
2. Kjo Rregullore do të aplikohet për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK).

Neni 2

Përkufizimet

2.1 Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 dhe Ligjit nr.04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (në vijim: Ligji për Fondet Pensionale) ose/dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:

- a) **“Pasqyrat financiare vjetore të audituara”**, nënkuptojnë pasqyrat financiare si bilanci i gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve

në ekuitet, shënimet plotësuese dhe materialet sqaruese, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

- b) **“Viti financiar”**, nënkupton periudhën nga 1 janar deri më 31 dhjetor të çdo viti.
- c) **“Open-End vehicles”**, nënkupton instrumente për investime të hapura.
- d) **“Tremujori” ose “tremujor”**, nënkupton periudhën e tre muajve të njëpasnjëshëm që fillojnë ditën e parë të çdo viti financiar, përveç nëse Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës përdor vit të ndryshëm financiar, tremujori përfundon çdo 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor të çdo viti.
- e) **“Certifikata e raportimit”** – nënkupton certifikatën unike të sigurisë e cila mundëson raportimin e fondeve në sistemin elektronik, vërteton se të dhënat e institucionit janë të enkriptuara dhe se në momentin që të dhënat importohen në sistemin rregullativ të raportimit “Off-Site” (angl. Off-Site Regulatory Reporting System – ORRS) fondet dhe personat përgjegjës marrin përgjegjësinë se të dhënat janë përfundimtare dhe të raportuara saktë.
- f) **“ORRS”** – nënkupton sistemin softuerik për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të raportuara nga institucionet financiare.
- g) **“Udhëzimet për raportim”** – nënkuptojnë udhëzimet e aprovuara për raportimin e institucioneve financiare në BQK ku janë të specifikuara format e raportimit, udhëzimet e detajuara për plotësimin e formave në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK) dhe rregulloreve të BQK-së si dhe elementet e tjera.

Neni 3

Kërkesat e Përgjithshme

1. FKKP, duhet të raportojë në bazë të kërkesave të përcaktuara me Ligjin për Fondet Pensionale dhe kërkesave të përcaktuara me këtë rregullore të cilat kanë të bëjnë me gjendjen e saj financiare, administrimin dhe operacionet, qoftë në bazë individuale apo të konsoliduar. Në bazë të kësaj rregulloreje, FKKP duhet t’i konsolidojë të dhënat e të gjitha aktiviteteve në një raport të vetëm.
2. Raportet përgatiten në format dhe udhëzimet e përcaktuara nga BQK-ja dhe ato mund të ndryshohen kohë pas kohe.

3. Në qoftë se data e raportimit nuk është ditë pune në Kosovë, data e raportimit do të jetë dita e parë e punës që pason.

Neni 4

Raporti i FKPK-së dhe Afati i Raportimit

1. FKPK duhet t'i raportojë Divizionit të Mbikëqyrjes Pensionale dhe Tregut të Letrave me Vlerë në BQK përmes ORRS, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas fundit të çdo muaji, raportet mujore në vijim:

- a) Bilancin e gjendjes (F1);
- b) Depozitat dhe plasmanët (F5);
- c) Inventarin e investimeve (F6);
- d) Blerjen dhe shitjen e instrumenteve financiare (F9);
- e) Mjetet neto dhe aksionet e kthyeshme (F14);
- f) Statistika - Bilanci i gjendjes (F19);
- g) Një listë e të gjitha mjeteve sipas investimeve në ditën e fundit të muajit për të cilin raportohet dhe muajit paraprak, ku krahasohen vlerat e tyre përkatëse;
- h) Shënime plotësuese dhe material sqarues, për ndryshimet e përgjithshme rritje/ zvogëlim për mjetet e investuara në tregun global sipas aset menaxherëve krahasuar me muajin paraprak;

2. FKPK duhet t'i raportojë Divizionit të Mbikëqyrjes Pensionale dhe Tregut të Letrave me Vlerë në BQK përmes ORRS, jo më vonë se njëzet¹ (20) ditë pas fundit të çdo tremujori, raportet tremujore në vijim:

- a) Pasqyrën e të ardhurave (F2);
 - b) Pasqyrën e ndryshimeve në mjetet pensionale neto (F3);
 - c) Derivatet e instrumenteve financiare (F8);
 - d) Të ardhurat nga instrumentet financiare (F10);
 - e) Llogaritë e pagueshme dhe të arkëtueshme (F11);
 - f) Shpenzimet e investimit (F12);
 - g) Shpenzimet operative (F13);
-

2.1 FKPK-ja duhet t'ia paraqesë në formë fizike Kuvendit, BQK-së dhe një kopje Qeverisë së Kosovës, jo më vonë se njëzet (20) ditë pas fundit të çdo tremujori këto forma të raportimit:

a) listën e të gjitha mjeteve pensionale duke përfshirë informacionet e kërkuara për raportin mujor të listuar në pikën (a) të paragrafit 1. të këtij neni;

b) pasqyrën mbi shitjen dhe fitimin e mjeteve pensionale së bashku me identitetin e mjeteve, datën e transaksionit, çmimin me të cilin është bërë shitblerja, si dhe ndërmjetësuesin e përdorur nëpërmjet të cilit është bërë transaksioni;

c) detajet e ndryshimit në vlerën e mjeteve të pensioneve gjatë tremujorit;

e) pasqyrë mbi kontributet e pranuar, ndryshimet në vlerën e mjeteve pensionale dhe pensionet e paguara gjatë tremujorit;

d) pasqyrë që prezanton numrin e kontribuuesve, që dalin në pension dhe vlerën e mjeteve pensionale në baza tremujore;

3. FKPK duhet t'i raportojë Divizionit të Mbikëqyrjes Pensionale dhe Tregut të Letrave me Vlerë në BQK përmes ORRS, jo më vonë se njëzet (20) ditë pas fundit të çdo gjashtëmujori, raportin si në vijim:

a) Pasqyrën e rrjedhës së parasë (F4);

4. FKPK duhet t'i raportojë Divizionit të Mbikëqyrjes Pensionale dhe Tregut të Letrave me Vlerë në BQK përmes ORRS, jo më vonë se njëzet (20) ditë kalendarike pas fundit të çdo viti kalendarik, përveç raporteve të specifikuar në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni edhe raportet si në vijim:

a) Tipologjinë e pjesëmarrësve (F15);

b) Hendekun e likuiditetit (F16);

Neni 5

Raporti vjetor

1. FKPK brenda 4 muajve pas përfundimit të vitit financiar duhet të dorëzojë në BQK raportin vjetor, së bashku me opinionin e auditorit të jashtëm dhe letrën e menaxhmentit për vitin e kaluar financiar.

2. FKPK brenda 5 muajve pas përfundimit të vitit financiar duhet të dorëzojë në Kuvendin e Kosovës, BQK dhe një kopje Qeverisë së Kosovës raportin vjetor, së bashku me opinionin e auditorit të jashtëm për vitin e kaluar financiar, me informacionin si në vijim:

- a. listën e mjeteve të pensioneve me datën e vlerësimit të ditës së fundit të vitit financiar, duke treguar pjesëmarrjen e mjeteve pensionale të investuara në klasa të veçanta të mjeteve. Ky raport duhet të përfshijë edhe investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, si një përqindje e totalit të kontributeve të arkëtuara nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin paraprak.
- b. pasqyrën me vlerën dhe proporcionin e mjeteve pensionale të investuara në klasat e veçanta të mjeteve, duke përfshirë detajet e letrave me vlerë të veçanta, me vlerësimin e muajit të fundit të periudhës vjetore.
- c. në rastin kur mjetet janë të investuara në “Open-End Vehicles”, informacion themelor mbi mjetet Open-End Vehicles në mënyrë, që pasuritë të mund të agregohen duke analizuar sistematikisht në mënyrë që të tregojnë një pamje të përgjithshme mbi ekspozimin e çdo fondi ndaj klasave të ndryshme të mjeteve.
- d. pasqyra e taksave dhe e shpenzimeve me të cilat është ngarkuar FKPK gjatë vitit financiar për investimet e mjeteve pensionale, duke përfshirë taksat e mbajtësit të mjeteve dhe taksat të tjera për shërbimet dhe transaksionet financiare, që ndërlihen me investimin e mjeteve pensionale,
- e. pasqyrën që arsyeton taksat e ngarkuara mbi llogarinë individuale gjatë vitit financiar dhe caktimin e programit të propozuar për taksa për vitin e ardhshëm financiar.
- f. të dhënat mbi alokimin e kontributeve të mbledhura dhe masën me të cilën kontributet janë të barazuara në llogaritë individuale.

Neni 6

Raportimi shtesë

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë mbikëqyrëse, BQK-ja mund të kërkojë, sipas nevojës dhe rastit, që të raportohet më shpesh ose në forma shtesë dhe më gjerësisht siç konsiderohet e nevojshme.

Neni 7

Detyrimet e FKPK-së

1. FKPK duhet të dorëzojnë raportet në afatet dhe në format e përcaktuara nga BQK-ja.
2. Raportimet nga FKPK sipas kësaj Rregulloreje që nuk bëhen përmes ORRS duhet të bëhet në formë fizike dhe elektronike.
3. Shkresa përcjellëse e raporteve në formë fizike të dorëzuara në BQK duhet të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga personi i cili është përgjegjës për njësinë që merret me plotësimin e raporteve dhe nga drejtori menaxhues ose i autorizuari i tij.

Neni 8
Informata të tjera

1. Anëtarët e Bordit Drejtues të FKPK duhet të paraqesin në BQK deri në ditën e fundit të muajit prill të secilit vit, në formularin e përpiluar nga BQK-ja, të hyrat personale individuale vjetore dhe raportet e hapura të mjeteve.
2. FKPK duhet të paraqes në BQK kopjen e deklaratës së parimeve të investimeve dhe direktivave brenda 30 ditësh prej datës së miratimit, ndryshimit apo përshtatjes së tij. FKPK duhet të paraqesë në BQK kopjen e direktivave për investime, nëse ka lëshuar një të tillë për menaxhuesit e mjeteve brenda 15 ditësh prej datës së lëshimit ose të ndonjë ndryshimi të tij.
3. FKPK do të dorëzojë në BQK deklaratën e menaxhimit të rrezikut të miratuar për të menaxhuar sigurinë e mjeteve pensionale.

Neni 9
Zbatimi dhe masat

Shkeljet e kësaj Rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara në nenin 33, të Ligjit për Fondet Pensionale.

Neni 10
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje do të shfuqizohet Rregullorja 5 mbi Raportimin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës të datës 29 maj 2014, si dhe çdo akti tjetër që bie në kundërshtim me këtë Rregullore.

Neni 11
Shtojca

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është Aneksi 1.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 shtator 2016.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci



**Divizioni i Mbikëqyrjes Pensionale dhe Tregut të Letrave me Vlerë
Fleta e parë dhe shkresa përcjellëse**

Emri i institucionit:

Kodi i institucionit:

Adresa:

Lloji i institucionit:

Periudha e raportimit:

Forma (frekuenca) e
raportimit:

Data e raportimit:

I audituar:

Data dhe ora e ngarkimit të raportimit:

Emërimi i raportit:

Formularët e raportimit:

Kodi	Emri i formularit	✓
F01	Bilanci i gjendjes	
F02	Pasqyra e të ardhurave	
F03	Pasqyra e ndryshimeve në mjetet pensionale neto	
F04	Pasqyra e rrjedhës së pasasë	
F05	Depozitat dhe plasmanët	
F06	Inventari i investimeve	
F07	Fondet investive të hapura	
F08	Derivatet e instrumenteve financiare	
F09	Blerja dhe shitja e instrumenteve financiare	
F10	Të ardhurat nga instrumentet financiare	
F11	Llogaritë e pagueshme dhe të arkëtueshme	
F12	Shpenzimet e investimit	
F13	Shpenzimet operative	
F14	Mjetet neto dhe aksionet e kthyeshme	

F15	Tipologjia e pjesëmarrësve	
F16	Hendeku i likuiditetit	
F19	Statistika - Bilanci i gjendjes	

Deklarata e zyrtarit përgjegjës për raportim, drejtorit financiar dhe personit përgjegjës për raportim.

Përmes kësaj deklarojmë se raportet e ngarkuara në ORRS janë përgatitur në përputhje me kërkesat e BQK-së dhe instruksionet për raportim. Raportet reflektojnë qartë kushtet e fondit deri në datën e informatës. Është e kuptueshme se çdo paraqitje e falsifikuar me qëllim në këtë raport mund të rezultojë me sanksione civile apo penale që do të zbatohen kundër zyrtarit përgjegjës për raportim, drejtorit financiar si dhe / ose fondit që raporton.

Drejtori Financiar:

(nënshkrimi)

Personi përgjegjës për raportim:

(nënshkrimi)